

**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**UNIVERSITETI “NËNË TEREZA” NË SHKUP
УНИВЕРЗИТЕТ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ ВО СКОПЈЕ**



**УНИВЕРЗИТЕТСКИ ГЛАСНИК
INFORMATORI UNIVERSITAR**

Nr. / Бр.16-1/2024

**Shkup, Janar 2024
Скопје, Јануари 2024**

Botim i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup
Издание на Универзитетот „Мајка Тереза“ во Скопје

Redaktor i veprimtarisë botuese të UNT-së/ Уредник на издавачката дејност на УМТ:
Prof.dr.Izet Zeqiri, rektor / Проф. д-р Изет Зеќири, ректор

Redaktor i Informatorit / Уредник на гласникот:
Prof.dr. Mustafa Ibrahim / Проф. д-р Мустафа Ибрахими
Mr. Bujar Kajolli / М-р Бујар Кајоли

Këshilli redaktues / Уредувачки одбор:
Prof.dr. Mustafa Ibrahim / Проф. д-р Мустафа Ибрахими
Prof. dr. Rizvan Sulejmani / Проф. д-р Ризван Сулејмани
Prof. Inor. dr. Fati Iseni / Вонр. Проф. д-р Фати Исени
Mukades Hajdari / Мукадес Хајдари

Rregullimi teknik / Техничко уредување
Mr. Bujar Kajolli / М-р Бујар Кајоли

PËRMBAJTJA/СОДРЖИНА

1. Програма за работа на кандидатот за декан на Факултетот за информатички науки
доц д-р Мајлинда Аџиу / Programi i punës i kandidatit për dekan të Fakultetit të
Shkencave Informatike doc. dr. Majlinda Axhiu ----- 6 - 12



PROGRAMI

Për punën e dekanit në periudhën e mandatit prej vitit 2024-2027
në
Fakultetin e Shkencave të Informatikës pranë
Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup

Shkup, Janar, 2024

Kandidati për dekan: Doc.Dr. Majlinda Axhiu
Fakulteti i Shkencave të Informatikës

Në bazë të nenit 115 të Ligjit për Arsimin e Lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë"
nr. 82/18) dhe në përputhje me nenin 238 paragrafi 6 të Statutit të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, kandidati Majlinda Axhiu, propozon

Programin për punën e dekanit në Fakultetin e Shkencave të Informatikës pranë Universitetit “ Nënë Tereza” në Shkup, në periudhën e mandatit 2024-2027

Hyrje

Duke e marrë si bazë rëndësinë dhe vlerën që posedon Fakulteti i Shkencave të Informatikës, në përbërje të Universitetit Nënë Tereza në Shkup, ky program ka për qëllim zhvillimin e metutjeshëm të Fakultetit, gjë për të cilën jam angazhuar që nga themelimi i tij e do të vazhdoj edhe më tej, tashmë në pozitë udhëheqëse nëse do ta kem mbështetjen e Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit.

Në kuadër të angazhimit tim do të mundohem që Fakulteti i Shkencave të Informatikës të jetë në rritje të vazhdueshme në fushën e veprimtarisë arsimore, kërkimoro-shkencore dhe aktivitete të tjera. Të gjitha ndryshimet dhe nismat e reja që do të ndërmerren do të jenë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, statutit dhe rregulloreve të Universitetit si dhe në marrëveshje dhe bashkëpunim të ngushtë me stafin akademik të Fakultetit.

Fakulteti i Shkencave të Informatikës ndër vite ka dëshmuar se është një nga shtyllat kryesore të Universitetit dhe ashtu siç është paraparë, numri i studentëve të interesuar vazhdimisht ka qenë në rritje. Për ti ruajtur ato suksese dhe vlera dhe për ti shtuar edhe me shumë, gjatë mandatit të rregullt për dekan, puna ime do të fokusohet në keto drejtime:

- Mbarëvajtjen dhe zhvillimin e procesit mësimor
- Zgjerimin e bashkëpunimeve të Fakultetit me institucione të jashtme arsimore dhe industriale në vend dhe jashtë vendit.
- Përkushtim dhe thellim në hulumtimet shkencore të cilat do të zhvillohen nga ana e stafit dhe inkuadrimi i studentëve në këtë proces.
- Përfshirja e studentëve në të gjitha proceset e zhvillimit të Fakultetit.
- Promovim më të gjerë të Fakultetit dhe programeve studimore të tij.

Programi është i përpiluar në bazë të interesave dhe synimeve të përbashkëta të Fakultetit dhe Universitetit. Qëllimet dhe aktivitetet e cekura nuk janë të limituara me kaq, andaj programi do të jetë gjithmonë i hapur për ide të reja progresive të cilat mund të vijnë nga stafi akademik, administrativ dhe nga studentët.

1. Aktivitete për organizimin, përmirësimin dhe avansimin e procesit mësimor

Meqenëse shtylla kryesore e Universitetit dhe Fakultetit është ofrimi i arsimit cilësor, fokusi primar do të jetë në mbarëvajtjen dhe cilësinë e procesit mësimor. Qëllimi im dhe i gjithë stafit akademik është që ti ofrojmë studentëve njohuri sa më të mëdha profesionale të cilat do të mund t'i aplikojnë lehtë në treg të punës ose në hulumtime shkencore më të avancuara. Për ta arritur këtë, do të duhet që secili anëtar i Fakultetit ta ruajë përgjegjësinë profesionale në të gjitha aktivitetet në kuadër të Fakultetit.

Qëllimet primare do të drejtohet drejt:

- Realizimit të suksesshëm të të gjitha programeve studimore, respektivisht të të gjitha lëndëve të paracaktuara.
- Shpërndarjes së lëndëve dhe detyrave të tjera në bazë të cilësive dhe ekspertizave të stafit akademik.
- Angazhimit për sigurim të kushteve të kënaqshme të punës.
- Evaluimit të stafit akademik për procesin mësimor dhe marrja në konsideratë e vlerësimeve nga ana e studentëve, me qëllim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie.
- Organizimit të punëtorive për shkëmbim të përvojave mes stafit akademik rreth implementimit të metodologjive të ndryshme në procesin mësimor.
- Inkurajimit për bashkëpunim mes mësimdhënësve në gërshetim të lëndëve (në kuadër të mundësive që i jep lënda), në angazhime të përbashkëta që do ti jepen studentëve, me qëllim që në fund studentët të mund të krijojnë një produkt softuerik të kompletuar.
- Përfshirjes së barabartë të të gjithë anëtarëve të stafit nëpër aktivitete dhe komisione në nivel të Fakultetit.

2. Mendime për programet studimore aktive në Fakultet dhe propozime për programe të reja studimore

Në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Informatikës aktualisht zhvillohet mësim në 4 programe të ndryshme studimore në studimet deridiplomike dhe në 2 (studime një-vjeçare dhe dy-vjeçare) programe studimore për studimet e ciklit të dytë. Aktualisht janë aktive të gjitha programet studimore me një numër të konsiderueshëm të studentëve, megjithatë interesi më i lartë është për programin tre-vjeçar 'Programim i Aplikuar' dhe për programin katër-vjeçar 'Shkencat kompjuterike dhe inxhinieri'. Konsideroj se me keto dhe me dy drejtimet e tjera (Informatikë dhe Informatikë-mësimdhënie), përfshihet një gamë e gjerë e fushave që aktualisht kërkohen nga Shkencat kompjuterike dhe teknologjitë. E rëndësishme është që bashkarisht të gjithë të fokusohemi në relizimin e tyre të plotë dhe ta ndjekim vazhdimisht progresin e studentëve. Ajo që është e nevojshme të ndryshohet është literatura që përdoret, e cila duhet të përditësohet krahas zhvillimeve të reja teknologjike.

Gjatë riakreditimit të programeve studimore, do të insistoj që grupet punuese të marrin mendime dhe sugjerime nga i gjithë stafi akademik i Fakultetit, me qëllim që pengesat që mund të kenë qenë, të zgjidhen duke i ndryshuar plan-programet.

Sa i përket programeve të reja, në këtë periudhë e shoh si mundësi dhe nevojë shtimin e programeve vetëm për ciklin e dytë të studimeve. Trendet e reja anojnë tek fushat interdisciplinare, prandaj do kisha sugjeruar që të ketë gërshetime me drejtimet e biznesit, sigurisë, linguistikës, etj. Megjithatë për këto propozime do të hapen diskutime të gjera në KMSH dhe duke u bazuar edhe në kërkesat e tregut, do të merren vendime të përbashkëta.

3. Hulumtimet shkencore të Fakultetit dhe angazhimi në projekte

Hulumtimet shkencore dhe publikimi i tyre nëpër revista shkencore ndërkombëtare me IF, janë indikator i kryesor për rangim të institucioneve të arsimit të lartë, qoftë në rangime vendase ose ndërkombëtare.

Stafi i FSHI-së ka potencial të lartë dhe përvojë të gjere në këtë fushë, prandaj dhe do të mundohem vazhdimisht t'i dal në përkrahje punës së tyre cilësore dhe t'i inkurajoj edhe me tej për hulumtime të reja, në fushat përkatëse.

- Do ta mbështes stafin e Fakultetit për cdo aktivitet hulumtues, respektivisht për cdo pjesëmarrje në konferenca shkencore, projekte dhe shkëmbime afatshkurtra në Universitete jashtë vendit. Do të kujdesem që të bëj kërkesë tek Universiteti për mbulesë të pjesshme të shpenzimeve të stafit, për realizim të ketyre aktiviteteve.
- Do të angazhohem maksimalisht që bashkarisht t'i realizojmë me sukses konferencat vjetore të Fakultetit tonë.
- Fokus i veçantë do t'i jepet cilësisë dhe publikimit të rregullt të revistës shkencore ndërkombëtare të Fakultetit tonë 'Journal of Computer Sciences and Mathematics'.
- Publikimi i teksteve universitare është gjithashtu një pikë e rëndësishme tek e cila do duhet të fokusohemi në të ardhmen, meqenëse ka mungesë të madhe të literaturës profesionale në gjuhët lokale.
- Do t'i inkurajoj studentët (veçanërisht studentët e ciklit të dytë) që të angazhohen në hulumtime shkencore ose projekte që mund të inicohen nga stafi ose nga vete ata.

4. Përfshirja e studentëve në aktivitetet e FSHI-së

I gjithë përkushtimi dhe puna për rritjen e cilësisë së Fakultetit e ka për qëllim arritjen e kënaqshme të pritshmërive të studentëve që i kanë nga ne. Konsideroj se është shumë thelbësore që në çdo proces të zhvillimit të Fakultetit të merren në konsideratë edhe mendimet, vlerësimet dhe idetë e propozuara nga ana e studentëve. Prandaj, menaxhmenti i fakultetit do të jetë gjithmonë i hapur për çdo kërkesë, ankesë apo ide progresive që do të mund të na i përcjellin, me qëllim që ta fitojnë ndjesinë dhe sigurinë se ata janë fokusi ynë dhe janë faktor në zhvillimin e Fakultetit. Për ta arritur këtë do të përkushtohem në:

- Përfshirjen e studentëve në aktivitete në nivel të Fakultetit dhe Universitetit.
- Inkurajimin e studentëve për të formuar klube të ndryshme, me qëllim që kohën që do ta shpenzojnë në Universitet ta kenë sa më produktive.
- Organizimin e paneleve të diskutimit për tema të ndryshme nga fusha e teknologjisë kompjuterike.
- Inkuadrimin e studenteve në projektet e Fakultetit, të cilat në përbërje do të kenë një pjesë të stafit akademik dhe studentët.
- Inkuadrimin e studenteve në aktivitetet promovuese të Universitetit. Është shumë e rëndësishme që studentët e ardhshëm të degjojnë përvojat e studenteve drejtpërdrejt nga ata, prandaj edhe përfshirja e tyre në promovim mendoj që do të jetë me efektive.
- Mbeshtetjen për pjesëmarrje në gara dhe punëtori, në rajon dhe më gjerë.
- Aktivizimin e tyre në Këshillim Mësimor Shkencor të Fakultetit. Deri më tani, përfaqësimi dhe prezenca e studenteve në KMSH ka qenë shumë e dobët, në të ardhmen do të kërkoj pjesëmarrje aktive të kryetarit të studenteve nëpër takimet e KMSH-se. Meqenëse është shumë e rëndësishme që studentët të jenë në rrjedhë me të gjitha vendimet që sillen në kuadër të Fakultetit, si dhe edhe për ne është e rëndësishme që vazhdimisht të jemi në dijeni për nevojat dhe kërkesat e tyre.
- Nxitja e shfrytëzimit të programeve për shkëmbim mes Universiteteve nga ana e studenteve, me qëllim që të fitojnë përvojat të reja të cilat pas rikthimit mund të bartin tek ne, si dhe ne të mundësojmë mesim cilësor studenteve të cilët do të vijnë aty nga Universitetet e tjera. Përvojat e deritanishme në këtë aspekt kanë qenë të suksesshme, prandaj edhe besoj se edhe ne të ardhmen do të jete mundësi e mirë për të përfituar ide nga përvojat e studenteve.
- Rrjetëzimin me studentët e diplomuar, do të jete një nga qëllimet e mia gjithashtu. Separi për ta përcjelle suksesin e tyre, por edhe për të shpërndarë përvojat e tyre tek studentët aktual, besoj që është shumë i rëndësishëm kontaktimi i vazhdueshëm me studentët tanë të diplomuar.

5. Aktivitete rreth bashkëpunimeve vendore dhe ndërkombëtare

Bashkëpunimi me organizatat dhe institucionet vendase apo ndërkombëtare, qoftë të fushës akademike apo të industrisë është një nga faktorët kryesor për ngritje të vlerave dhe peshës së Fakultetit. Duke u bazuar në këtë parim, në periudhën kohore në të cilën do të kem mundësi të udhëheq me Fakultetin, do të mundohem t'i inicoj dhe përkrah të gjitha aktivitetet e mëposhtme.

- Stafi do të inkurajohet për tu angazhuar rreth thellimit të bashkëpunimeve aktuale dhe inicimit të bashkëpunimeve të reja me Universitetet ndërkombëtare, duke i mundësuar shfrytëzimin e mundësive të shkëmbimit përmes programeve ndërkombëtare si Erasmus+ dhe të tjera.

- Stafi akademik do ta ketë lirinë akademike për të ftuar ligjërues dhe specialistë të fushës nga institucione të tjera, me ç'rast studentët do të kenë mundësi të përfitojnë njohuri të reja plotesuese.
- Do të inicojme bashkëpunime me institucionet vendore të sektorit privat dhe publik, me qëllim të shkembimit të përvojave, të pasqyrimit të nevojave në treg dhe plotesimit të tyre nga ana e programeve tona studimore. Këto bashkëpunime me kompani të ndryshme studentëve do t'ia lehtësojnë dukshëm edhe relizimin e punës praktike.
- Stafi akademik bashkë me studentët do të mbështeten në idetë e tyre për projekte me të cilat mund të aplikohet edhe për thithje të fondacioneve të ndryshme Evropiane.

6. Aktivitete rreth promovimit të Fakultetit dhe Universitetit

Promovimi i vlerave të FSHI-së dhe i perspektivës së lartë të drejtimeve që bartim është shumë i rëndësishëm për rritjen e numrit të studentëve në Fakultet. Aktivitetet e viteve të kaluara kanë rezultuar të suksesshme, meqenëse numri i studentëve ka qenë në trend rrites për secilin vit akademik. Prandaj, do të përkushtohem që ato aktivitete të intensifikohen dhe të përfshihen edhe metoda të reja për të arritur deri tek vëmendja dhe interesi i nxënësve të shkollave të mesme/studentëve të ardhshëm. Disa nga aktivitetet që i planifikoj në kuadër të programit janë:

- Pjesëmarrje aktive në organizimin e ditëve të hapura që organizohen në nivel universitar.
- Promovimi i Fakultetit përmes vizitave nëpër shkollave të mesme të vendit dhe në rajon.
- Organizimi i garave dhe punëtorive për nxënësit e shkollave të mesme.
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme, si 'Ora e kodimit', ku qëllimi do të jetë që nxënësit për një periudhë të shkurte kohore të njohet me kodim. Me këtë do të mundohemi që nxënësve t'ia bëjmë me të afert fushën e shkencave kompjuterike dhe ta rrisim interesin e tyre.
- Organizim i aktiviteteve mes studentëve tani aktual dhe nxënësve të shkollave të mesme.
- Promovim më aktiv në botën digjitale.

7. Aktivitete të tjera

Përveç pikave të planifikuara që janë cekur më lart, në kuadër të menaxhimit gjithëpërfshirës do të angazhohem edhe për çështjet në vijim.

- Do të inicoj dhe do t'ia mbështes të gjitha nismat për përmirësim të kushteve të punës, duke u angazhuar për të siguruar laboratore cilesore, si për zhvillimit të mesimit ashtu edhe për punë hulumtuese.
- Bashkë me grupin udhëheqës do të angazhohemi që të përpilojmë një rregullore në kuadër të Fakultetit, ku do të vendosen të gjitha standardet dhe rregullat interne për funksionim të Fakultetit të cilat do të miratohen nga KMSH.

- Do të angazhohem në rritjen e efikasitetit të punëve administrative në lidhje me çështjet studentore, me qëllim që studentet të fitojnë shërbime kualitative dhe në kohe të krenarshme.
- Do të vazhdoj me kërkesat për zgjerim të stafit akademik, respektivisht për inkuadrim të bashkëpunësve të rinj, me qëllim që mbulesa e lendeve të kryhet në formë të rregullt dhe të rrisim cilësinë që jemi duke ia ofruar studentëve.

Përfundim

Programi i propozuar konsideroj se është gjithëpërfshirës për shtyllat dhe qëllimet kryesore të fakultetit, por edhe sfidues për realizim të të gjitha aspekteve, meqenëse Fakulteti jonë si njësi e Universitetit nuk është plotësisht i pavarur dhe një pjesë e realizimit të pikave të planifikuara varet edhe nga vendimet e trupave udhëheqës të Universitetit.

Asnjë nga aktivitetet e parapara nuk do të jetë plotësisht i realizueshëm pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e gjithë stafit të Fakultetit. Prandaj e inkurajoj stafin që të kemi bashkëpunim të mirëfilltë me qëllim që të realizojmë qëllimet tona, edhe përkundrazi faktorëve të jashtëm që ndonjëherë mund të na paraqiten si pengesa.

Gjatë punës dhe përkushtimit tim të pakursyer zotohem se do të kryej punën me përgjegjësi, profesionalizëm dhe etike profesionale dhe kolegjiale. Do të kujdesem që mos cenohen të drejtat e asnjë anëtar të stafit, dhe gjithmonë do të mundohem ta nxis frymën pozitive të bashkëpunimit. Besoj se me vullnet të mirë nga të gjithë palët, mund t'i rrisim vlerat e Fakultetit të Shkencave të Informatikës.

Kandidati për Dekan,

Majlinda Axhiu

18.01.2024